



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Tiranë, më 4.4.2025

Lënda: Bisedimet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në çështjen me objekt: Ankim kundër vendimit nr. 521, datë 1.4.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Erjon Shehaj

Të nderuar gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit!

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha kërkimet dhe prapësimet e palëve, si dhe provat e administruara në kuadër të këtij gjykimi, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke iu qëndruar shkaqeve të ankimit të datës 3.6.2022, parashtrimeve dhe shpjegime të dhëna në formë verbale të pasqyruara në procesverbalin e seancës gjyqësore publike të datës 19.3.2025, vlerëson se:

Lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale

1. Për procedimin penal me nr.*, viti 2014**

1.1. Lidhur me këtë shkak ankimi, **vlerësojmë se** edhe pas shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e shkaqeve të ankimit dhe rrethanat e rastit konkret mbeten të njëjta

1.2. Ashtu sikurse Komisioni, ka arsyetuar, **vlerësojmë se** subjekti nuk dha shpjegime bindëse mbi gjetjet dhe të metat e veprimeve procedurale të kryera prej tij e të konstatuara në aktet e fashikullit procedural konkret.

1.3. Konstatojmë gjithashtu se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje, në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, pasi nuk ka ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të konkluduar bazuar në këto elemente, prova dhe ligj.

1.3.1. Në procedimin penal nr.***/2014, jemi para rastit kur një punonjës policie, duke ecur në rrugë, ndeshet me një person, të cilit i kishte ushtruar kontroll një natë më parë dhe personi në fjalë (autori i veprës penale) lëshon fjalë kanosëse ndaj tij, si dhe e

godet me pëllëmbë në gjoks e i merr rrëmbimthi syzet. Ky është fakti penal, i cili është kallëzuar, ditën e ndodhjes së ngjarjes dhe është deklaruar po ditën e ndodhjes së ngjarjes nga punonjësi i policisë. Gjithashtu provohet nga hetimi se, punonjësi i policisë, një ditë më parë, kishte ushtruar kontroll personal te subjekti i veprës penale. Policia Gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Lezhë ka referuar çështjen në Prokurorinë Lezhë për dy vepra penale, dhe më konkretisht: goditje për shkak të detyrës, parashikuar nga neni 237, pika 3, e Kodit Penal, (sepse i dëmtuari është punonjës policie) dhe kanosje për shkak të detyrës parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal.

1.3.2. Konkurrimi ose jo i këtyre dy veprave penale vlerësoj se është pjesë e diskrecionit të prokurorit, por ajo që bën përshtypje është fakti se megjithëse i dëmtuari nga vepra penale, i cili në rastin konkret është punonjësi i Policisë së Shtetit, ka qenë i qartë sa i takon faktit penal dhe autorit të veprës penale duke shpjeguar momentin e ndodhjes së ngjarjes, veprimet dhe komunikimin e autorit të dyshuar të veprës penale (kallëzim i kryer dhe deklarim i dhënë menjëherë pas ngjarjes në datën **.6.2014, ku dhe memoria e secilit është më e freskët dhe i riprodhon ngjarjet më me saktësi) pas rreth disa javësh, dhe më konkretisht në datën **.07.2014, në mënyrë komplet të panevojshme, ripyetet nga oficeri i policisë gjyqësore i deleguar për kryerjen e veprimeve hetimore. Në kallëzimin dhe deklarimin e datës **.6.2014 i dëmtuar nga vepra penale ka shpjeguar qartë fjalët kanosëse, fyerjet, goditjen me pëllëmbë në gjoks, rrëmbimin e syzeve të diellit, në deklarimin e datës **.07.2014 punonjësi i policisë së shtetit *** ***, jep një panoramë të ndryshme nga ajo e dhënë në datën **.06.2014 ku tashmë nuk deklaroi kanosjen, fyerjet, sharjet, goditjen me pëllëmbë etj, deklarime që shkojnë në favor të autorit të veprës penale. Në vlerësimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme ripyetja e të dëmtuarit nga vepra penale, në datën **.07.2014 ishte e panevojshme pasi ai kishte qenë shterues në momentin e dhënies së kallëzimit dhe në momentin e dhënies së deklarimit, por në ripyetjen e datës **.07.2014, ai ripyetet për të njëjta rrethana dhe jep një situatë tjetër. Ripyetja e punonjësit të policisë legjitimohet kur është e nevojshme të japë për shpjegime për rrethana a të dhëna që nuk i ka deklaruar në deklaratimet e mëparshme apo për të qartësuar pasaktësi të dhëna në deklarime të mëparshme.

1.3.3. Edhe pse në deklaratimet e datës **.07.2014 i dëmtuari nga vepra penale bën deklarime të ndryshme nga ato të dhëna në datën **.6.2014, oficeri i policisë gjyqësore për asnjë moment nuk e konfronton deklaruesin, nuk e ballafaqon dhe nuk e pyet fare pse ndryshoi shpjegimet e tij. Rezulton se gjatë fazës së hetimit janë kryer edhe disa veprime të tjera hetimore kryesisht pyetje e shokëve të të dyshurit të cilat shkojnë në favor të autorit të veprës penale. Pas administrimit të këtyre provave dhe zgjatjes së përsëritur të afateve të hetimit paraparak (pa asnjë argument) në datën **.01.2015 prokurori konkludon me një vendim pushimi me arsyetimin se nuk ndodhemi para veprës penale të goditjes për shkak të detyrës. Vlen të theksoj se në vendimin e pushimit, nuk merret në analizë dhe nuk i jepet vlerë provuese për asnjë moment deklarimit dhe kallëzimit të dhënë nga ana e të dëmtuarit nga vepra penale në datën

******.06.2014, por pjesë e analizës janë vetëm deklaratimet e tij të datës ******.07.2014, deklaratimet e të dyshuarit si autor i veprës penale dhe të disa prej shokëve të tij.

1.4. Pa u futur në interpretimin apo në analizën se si i çmon faktet prokurori për sa i takon konkurrimit të veprave penale, vlerësojmë të drejtë ankimin e Komisionerit pasi hetimi është orientuar dhe janë kryer veprime drejt pushimit të çështjes penale, dhe zgjidhja në themel e fatit të procedimit penal është edhe produkt i këtyre të metave procedurale, apo dhe materiale të cilat kanë çuar në një vendimmarrje të tillë krahas edhe problematikave të tjera që janë evidentuar.

1.5. Për sa arsyetuar më lartë, vlerësojmë se moskryerja e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme, mënyra jo e saktë e vlerësimit të fakteve dhe provave, argumentimi jo i plotë dhe jo në përputhje me dispozitat ligjore, bien ndesh me kriteret e parashikuara në nenin 73, pikat 2 dhe 3, dhe 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, dhe duhen të merren nga Kolegji në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes në kuptim të nenit 4 pika 2 të ligjit nr.84/2016, i ndërlidhur me nenin 61, pika 5 të tij.

2. Për procedimi penal nr. *, viti 2014.**

2.1. Lidhur me këtë shkak ankimi, **vlerësojmë se** edhe pas shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e shkaqeve të ankimit dhe rrethanat e rastit konkret mbeten të njëjta.

2.2. Vlerësojmë ndryshe nga Komisioni, pasi në rastin konkret vërejmë se në aktet e hartuara nga subjekti i rivlerësimit mungon arsyetimi ligjor mbi ndryshimin e cilësimit të veprës penale nga ajo e referuar nga oficeri i policisë gjyqësore: “*Plagosje e lehtë me dashje në bashkëpunim*”, të parashikuar nga neni 89 dhe 25 i Kodit Penal, në atë me të cilën ka regjistruar procedimin penal “*Plagosje e lehtë me dashje*”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, dhe atë me të cilën ka vendosur pushimin e ndjekjes së kësaj vepre penale, si “*Dëmtime të tjera me dashje*”, parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal, si vepra që duhet të ndiqen kryesisht në Gjykatë

2.3. Referuar këtij qëndrimi, arsyetimi i subjektit mbi përdorimin e një akt ekspertimi që i përket një procedimi tjetër, më të hershëm në kohë, mbi një mjet të pretenduar se mund të jetë kryer vepra penale, nuk mbështetet nga rrethanat, deklaratimet dhe aktet në dosje, e për më tepër përmbajtja e të dhënave të këtyre akteve procedurale, mbi natyrën e mjetit (armë e ftohtë) është kontradiktore. Po ashtu, arsyetimi në lidhje me kryerjen e veprës penale në kushtet e parashikuara nga neni 25 i Kodit Penal, mungon.

2.4. Këto mangësi në kryerjen e veprimeve hetimore dhe arsyetimin e akteve procedurale, duket kanë sjellë pasoja në mbrojtjen e posaçme ligjore të marrëdhënieve juridiko-shoqërore të rëndësishme (shëndetit të shtetasve), si dhe eventualisht në të drejtat procedurale të të dëmtuarit nga kryerja e veprës penale.

2.5. Në këto rrethana, **vlerësojmë se** gjetjet mbi këtë procedim penal janë të tilla që duhen vlerësuar në raport me indikatorët e nenit 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, më së paku, në raport me treguesit e cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik të prokurorit,

dhe duhen të merren nga Kolegji në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes në kuptim të nenit 4 pika 2 të ligjit nr.84/2016, i ndërlidhur me nenin 61, pika 5 të tij.

3. Për procedimin penal me nr. *, viti 2020**

3.1. Për sa janë administruar në akte në dosjen e Komisionit, **vlerësojmë se** subjekti nuk arrin të provojë të kundërtën e barrës së provës. Regjistrimi i procedimit penal, me cilësim ndryshe nga veprat penale të referuara nga Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, Lezhë, duket se ka mundësuar lehtësimin e pozitës procedurale të shtetasit *** **.

3.2. Refuzimi për t'iu bindur urdhrave të Policisë, bazuar në rrethanat e referuara në aktet procedurale, të hartuara për efekt të këtij procedimi penal, nuk lidhet me refuzimin për realizimin e testit të alkoolit, por, sikundër parashtrohet në akte, është realizuar nëpërmjet veprimeve konkrete, duke refuzuar shtetasi *** **, për t'u ndalur përpara shenjave të policisë, si dhe kryerja e manovrave të rrezikshme në drejtim, me qëllim për t'iu shmangur shërbimeve policore.

3.2.1. Në procedimin penal konkret gjetjet që ka bërë Komisioni i konsiderojmë të drejta, por rezulton se Komisioni këtyre gjetejeve nuk iu ka dhënë vlerë provuese, por ka mbajtur në konsideratë qëndrimin e subjektit të rivlerësimit në pyetjet dhe përgjigjet e dërguara atij.

3.2.2. Sipas informacionit të referimit të veprës penale, që është i datës **.11.2020, dhe raportit të shërbimit të punonjësve të policisë të cilët kanë rënë në kontakt të parë me *** **, rezulton qartësisht, që kemi element të veprës penale të mosbindjes ndaj punonjësit të policisë së rendit publik, dhe policia e ka referuar dhe këtë vepër penale krahas asaj të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Duke iu referuar raportit të shërbimit të mbajtur nga punonjësit e policisë, rezulton se më datë **.11.2020, rreth orës 1:30 minuta, ky shtetas ka qenë duke drejtuar automjetin autoveturë të markës benz me targa AA ***, në rrugën "****", *** **, në qytetin Lezhë dhe nuk është bindur për t'iu ndaluar shërbimit të policisë, dhe është larguar në drejtim të tregut Lezhë. Pas ndjekjes nga shërbimet e policisë Lezhë është kapur në afërsi të objektit "**** **" dhe është shoqëruar në Komisariatin e Policisë Lezhë. Meqenëse shtetasi *** ** po ecte në mënyrë të rrezikshme me automjetin e tij, ishte e domosdoshme kryerja e testit të alkoolit me aparat drager veprim ky i kundërshtuar nga subjekti i veprës penale.

3.2.3. Nga aktete e procedimit penal rezulton se kemi dy fakte penale, njëri fakt penal është mosbindja e autorit të veprës penale ndaj punonjësit të policisë të cilët ishin në shërbim, dhe që i kanë bërë shenjë për të ndaluar. Ky person jo vetëm që nuk ka ndaluar, por është larguar dhe vetëm falë ndjekjes të pandërprerë të bërë nga ana e policisë gjyqësore është gjetur, lokalizuar dhe më tej është shoqëruar në polici.

3.2.4. Në vlerësim të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, që nga momenti që nuk iu bind patrullës së policisë, largimi më tej dhe fshehja në një vend ku e gjeti policia falë ndjekjes së pandërprerë është konsumuar vepra penale mosbindja ndaj punonjësit të policisë së rendit publik, parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal. Kurse drejtimi i

automjetit në mënyrë të parregullt është një veprë penale tjetër, që merr në mbrojtje marrëdhënie të tjera juridike të ndryshme nga marrëdhëniet që merr në mbrojtje vepra penale e parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal dhe të dy këto vepra penale konkurrojnë pasi janë në dy seksione komplet të ndryshme, të Kodit Penal. Megjithëse punonjësit e policisë që kanë mbajtur raportin e shërbimit nuk janë pyetur gjatë hetimit paraprak të këtij procedimi, raporti i shërbimit edhe referimi japin indicie ndoshta jo prova, që jemi dhe para veprës penale të parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal, edhe ndaj arrestimi në flagrancë është bërë për dy vepra penale (për veprat penale të parashikuara nga nenet 291 dhe 242 të Kodit Penal). Nga aktet e procedimit penal rezulton se në asnjë moment nuk është hetuar në drejtim të veprës penale të mosbindjes ndaj punonjësit të policisë.

3.2.5. Ky fakt penal nuk gjen pasqyrim në aktin fillestar të prokurorit që është urdhri i regjistrimit të procedimit penal dhe më tej në të gjithë aktet e prokurorit të marra në funksion të këtij procedimi penal. Në urdhër citohet se: "Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë datë **.11.2020 ka administruar materialet hetimore, të referuara nga policia gjyqësore me shkresën nr.*** prot., datë **.11.2020, pasi më datë **.11.2020, nga shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë është konstatuar se drejtuesi i mjetit me targë AA ***, shtetasi *** *** pranë vendit të quajtur qendra tregtare "**** ***", ("**** ****" ishte ku ai u kap, u lokalizua) të Bashkisë Lezhë po lëvizte me mjet nën efektin e pijeve alkoolike". Ky është fakti penal që përshkruhet në urdhërin e regjistrimit të procedimit penal të përpiluar nga subjekti i rivlerësimit dhe që pasohet nga të gjithë aktet e tjera procedurale që ka marrë prokurori gjatë hetimit të këtij procedimi penal. Aktet e hartuara nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të ngarkuar me hetimin e procedimit penal në fjalë nuk përshkruajnë fare faktin penal të konstatuar nga punonjësit e policisë, konstatim që e kanë materializuar me një dokument që quhet raport shërbimi i punonjësve të policisë, dhe që nëpërmjet pyetjes së tyre mund të shndërrohej në prove.

3.3. Në vlerësim të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme nga ana e subjektit të rivlerësimit, gjatë hetimit të këtij procedimi penal duket se nuk janë kryer veprimet e nevojshme hetimore, nuk janë pasqyruar drejtë faktet penale të ndodhura, ka një kuptim dhe interpretim të gabuar të ligjit penal material dhe më konkretisht të elementëve të veprës penale të parashikuar nga neni 291 dhe 242 të Kodit Penal si dhe aktet procedurale nuk janë arsyetuar drejt dhe në mënyrë shteruese. Këto veprime, duket se kanë sjellë pasoja në mbrojtjen e posaçme ligjore të marrëdhënieve juridiko-shoqërore të rëndësishme që merr në mbrojtje neni 242 i Kodit Penal etj.

3.4. Sa më sipër, konstatojmë se nga të dhënat e administruara si rezultat i informacioneve të organeve ligjzbatuese, duket se rezultojnë disa rrethana, të cilat, të analizuar së bashku me rezultatet e tjera të hetimit në vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe të para në raport me njëra-tjetrën, duhen çmuar nga Kolegji, në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes në kuptim të nenit 4 pika 2 të ligjit nr.84/2016, i ndërlidhur me nenin 61, pika 5 të tij.

4. Për procedimin penal nr. *, viti 2017**

4.1. Vlerësojmë se, në referencë të vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër, nr.***/2020, i cili, ndër të tjera, ka argumentuar se: [...] *Pra në të dyja akuzat rezulton edhe specifikimi si në lidhje me faktin e mashtrimit, duke përvetësuar pasurinë monetare të së njëjtës viktimë, *** ** për blerjen e të njëjtave pasuri, ashtu dhe mënyra dhe koha në të cilën janë marrë.....se Prokuroria sipas nenit 290, pika 1 shkronja “e” e Kodit të Procedurës Penale, nuk duhej të fillonte ushtrimin e ndjekjes penale për të njëjtat fakte për të cilat shtetasit *** dhe *** ** ishin gjykuar njëherë, pasi i tillë pushtet ishte konsumuar më parë me ushtrimin e ndjekjes penale në ngritjen e parë të procesit para Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë e që ka përfunduar me vendim të formës së prerë.....veprimi i parimit “ne bis in idem” nuk lejon vazhdimin e procedimit, pasi me vendim të formës së prerë të pandehurit *** ** dhe *** ** janë gjykuar njëherë për të njëjtin fakt penal.[...] shpjegimet e subjektit dhe bazueshmëria e vendimit të Komisionit mbi to, nuk gjejnë mbështetje në ligj.*

4.2. Situata faktike e procedimit penal nr.***, viti 2017, të ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, në vlerësim të rrethanave të hetuara më parë nga kjo Prokurori, lidhur me veprimet hetimore, vlerësimin e provave dhe aktet e administruara, do të duhet të vlerësohen referuar indikatorit të parashikuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 dhe duhen të merren në konsideratë nga Kolegji në vlerësimin tërësor të çështjes në kuptim të nenit 4 pika 2 të ligjit nr.84/2016, i ndërlidhur me nenin 61, pika 5 të tij.

5. Për procedimin penal nr. *, viti 2015**

5.1. Vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë të kundërtën e barrës së provës. Në këto rrethana të pranuara edhe nga Komisioni, procedimi penal nr.***, i vitit 2015, nuk duhej të transferohej për inspektim të shkeljeve pranë organit kompetent, të juridiksionit të zakonshëm disiplinor, pasi është në tejkalim të afateve kohore të parashikuara nga neni 117 i ligjit nr. 96/2016.

5.2. Gjetjet dhe rrethanat e konfliktit të interesit, të konstatuara nga Komisioni në këtë çështje, duhen vlerësuar së bashku me gjetjet e tjera, në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional të subjektit të rivlerësimit, në referencë të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, dhe duhen të merren në konsideratë nga Kolegji në vlerësimin tërësor të çështjes në kuptim të nenit 4 pika 2 të ligjit nr.84/2016, i ndërlidhur me nenin 61, pika 5 të tij.

6. Për procedimin penal nr. *, viti 2018**

6.1.Lidhur me këtë shkak ankimi, **vlerësojmë se** edhe pas shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e shkaqeve të ankimit dhe rrethanat e rastit konkret mbeten të njëjta.

6.2.Në procedimin penal konkret rezulton nga aktet sa vijon:

6.2.1. Shtetasi *** ** është arrestuar në flagrance, akuzuar dhe deklaruar fajtor për dy vepra penale që praqesin rrezikshmëri shoqërore shumë të madhe si “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” e parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe “Mbajtja pa leje

dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit” parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal, pasi në gomën rezervë të automjetit që drejtonte janë gjetur të fshehura dhe janë sekuestruar në cilësinë e provës material një sasi prej 2 kg e 886 gram lëndë narkotike si edhe 4 paketime lëndë eksplozive TNT ku në tre prej tyre është ngjitur edhe një telefon celular ku prej telefonave dilnin fije përcjellësash elektrikë.

6.2.2. Vlerësoj se nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk janë kryer veprime të plota hetimore në drejtim të dy veprave penale dhe autorëve të mundshëm të tyre. Në fashikullin e procedimit penal ka indicje dhe të dhëna edhe për persona të tjerë që mund të jenë përfshirë në këtë aktivitet kriminal, por nga ana e subjektit nuk është hetuar në këtë drejtim. Nuk rezulton që subjekti të ketë hetuar se: Ku e mori i arrestuari lëndën narkotike? Ku do e çonte ky person këtë lëndë narkotike? Ku e mori ky person këtë lëndë eksplozive? Ku do e çonte ky person këtë lëndë eksplozive? Nuk është kryer as edhe një veprim hetimor në këtë drejtim. Subjekti i rivlerësimit duhej që të hetonte në drejtim të bashkëpunëtorëve në krim të të arrestuarit dhe të shikonte mundësinë që ti atribuohet kryerja e veprave penale në bashkëpunim. Nëse do ishim përpara bashkëpunimit, të arrestuarit do ti atribuohet vepra penale e parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal e cila ka rrezikshmëri shoqërore më të madhe dhe parashikon dënimin me burgim nga 7-15 vjet burgim.

6.2.3. Sa i takon bashkimit të dënimeve rezulton se nga ana e subjektit të veprës penale, është kërkuar dënimi për secilën prej veprave penale në minimumin që parashikojnë dispozitat përkatëse prej 5 vjet dhe në bashkim të dënimeve dënimi po me 5 vjet burgim. Në vlerësim të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme duket se subjekti i rivlerësimit duke zbatuar gabimisht dispozitën e parashikuar nga neni 55 i Kodit Penal ka favorizuar subjektin e veprës penale. Vlerësoj se ishim para rastit të aplikimit të metodës së ashpërsimit të dënimit të parashikuar nga neni 55/1 dhe 2 i Kodit Penal dhe ndaj të pandehurit duhej të ishte caktuar dënimi më i rëndë i shtuar. Subjekti i rivlerësimit në kërkesën për caktimin e një dënimi të vetëm ka aplikuar nenin 55/3 të Kodit Penal duke kërkuar si dënim përfundimtar dënimin më të rëndë të të caktuar për një nga veprat penale (5 vjet burgim). Aplikimi i nenit 55/3 të Kodit Penal mund të bëhet vetëm në rastet kur kryerja e shumë veprave penale nuk tregon rrezikshmëri shumë të madhe të faktorit, por nisur nga lloji i veprave penale për të cilat është deklaruar fajtor i pandehuri, rrethanat e kryerjes së tyre rezulton se neni 55/3 i Kodit Penal nuk mund të aplikohet.

6.2.4. Përsa i përket pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim, dua të theksoj se neni 59 i Kodit Penal, është një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm. Siç parashikon neni 59 i Kodit Penal për tu aplikuar kjo dispozitë duhet që në mënyrë kumulative të ekzistojnë disa kriterë apo kushte të cilat kanë të bëjnë në radhë të parë me rrezikshmërinë shoqërore të veprës dhe të autorit, qëndrimin e tyre pas kryerjes së veprës penale dhe në radhë të dytë me ato rrethana apo kushte që janë tipike për të pandehurin dhe që kanë të bëjnë me nevoja personale, familjare siç mund të jetë shkollimi, sëmundja, detyrim ndaj fëmijve të mitur etj.

6.2.5. Në rastin e të gjykuarit mungojnë kriteret dhe kushtet që neni 59 i Kodit Penal ka parashikuar. Së pari në lidhje me rrezikshmërinë shoqërore të veprës dhe të autorit dua të them se ato janë të një natyre të atillë saqë nuk të lejojnë aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal. Vepra penale e parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, paraqet rrezikshmëri shoqërore të madhe dhe kjo nisur nga fakti se ajo dënohet me burgim nga 5 deri në 10 vjet. Rrethanat e kryerjes së veprës penale flasin qartë për një rrezikshmëri shoqërore të lartë të autorit. Ai e ka kryer veprën penale me dashje direkte si formë më e lartë e fajit, pasi ai me dashje direkte mbante, duke udhëtuar me automjet dhe duke fshehur në gomën rezervë të tij një sasi të konsiderueshme narkotike. Mbajtja dhe transportimi i kësaj lënde narkotike me qëllim shitje në të tilla rrethana shton rrezikshmërinë shoqërore të lartë të të pandehurit dhe të veprës penale të kryer prej tij. I njëjti arsyetim vlen edhe në lidhje me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal në sanksionin e së cilës parashikohen marzhe të larta dënimi. Sasia e konsiderueshme e lëndës plasëse e cila ishte e gatshme për të shpërthyer në distancë shton gjithashtu rrezikshmërinë shoqërore të veprës dhe autorit. Ndryshe është ti gjesh një sasi eksplozive tjetrit, në bagazhin e makinës, thjesht eksploziv, situatë komplet tjetër është nëse ti i gjen një sasi eksplozivi në një celular i gatshëm për t'u shpërthyer në distancë pasi jepet indicia, e dhëna që kjo do përdoret në një vepër tjetër penale dhe rezulton se nuk hetohet fare në këtë drejtim.

6.2.6. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit në kërkesën e tij për të aplikuar neni 59 i Kodit Penal ka dështuar që të individualizojë atë rrethanë të posaçme personale apo familjare që e çuan atë në kërkesën për tu aplikuar kjo dispozitë. Në konkluzionet e prokurorit (subjektit të rivlerësimit) nuk ka një përshkrim se cilat ishin ato rrethana të posaçme personale apo që e çuan atë në kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal. Subjekti i rivlerësimit nuk i ka përshkruar këto rrethana pasi ato nuk ekzistojnë. Nga aktet del se i pandehuri është madhor, nuk është në process shkollimi, nuk ka detyrime ekskluzive familjare apo prindërore, nuk vuan nga ndonjë sëmundje etj.

6.2.7. Vlerësojmë se gjetjet e rezultateve të hetimit, dhe mbi këtë procedim penal, duhen t'i nënshtrohen juridiksionit rivlerësues të Kolegjit, më së paku, lidhur me analizën dhe arsyetimin logjik të prokurorit mbi aplikimin e nenit 55 të Kodit Penal, lidhur me referimin e dënimit më të rëndë të shtuar, si dhe ekzistencën e kushteve për zbatimin e nenit 59 të Kodit Penal, në drejtim të indikatorëve të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, duke u vlerësuar në referencë të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, dhe duhen të merren në konsideratë nga Kolegji në vlerësimin tërësor të çështjes në kuptim të nenit 4 pika 2 të ligjit nr.84/2016, i ndërlidhur me nenin 61, pika 5 të tij.

7. Për procedimin penal nr. *, viti 2020**

7.1. Përsa sa kohë që është në gjykim akoma, madje subjekti i rivlerësimit ka paraqitur prova që çështja është për gjykim, edhe të cilat na janë vënë në dispozicion, ka paraqitur prova që çështja është për gjykim para Gjykatës së Apelit vlerësojmë se nuk mund të futemi në vlerësimin e çështjes. Vetëm ai moment për të cilin edhe është ankumuar është momenti i njoftimit të trashëgimtarëve të viktimës së veprës penale.

8. Në përfundim të shkaqeve të ankimit të trajtuar më sipër, në zbatim dhe të jurisprudencës së Kolegjit, për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe etikës së subjektit të rivlerësimit, vlerësojmë se të metat e konstatuara në shqyrtimin e çështjeve të trajtuara sa më lart, duhet të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave të çështjes së subjektit të rivlerësimit në konsideratë në kuptim të nenit 4 pika 2 të ligjit nr.84/2016, i ndërlidhur me nenin 61, pika 5 të tij

I. Kërkimi përfundimtar

9. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke iu qëndruar shkaqeve të ankimit të datës 3.6.2022, mbështetur në sa më sipër trajtuar, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, pikës 2, të nenit 4, pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr.521, datë 1.4.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Erjon Shehaj

DREJTUESI I PROKURORISË SË POSAÇME

Altin DUMANI